



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti
Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor
Nr : 04-353/01-26420
Data: 17.04.2025
P r i z r e n

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

DREJTORIA PËR URBANIZËM DHE PLANIFIKIM HAPËSIROR KK – PRIZREN,
me kërkesën e **Nikollë Kaçinarit - Prizren,** me të cilën pala ka kërkuar leje për dhënjën e pëlqimit për ngritjen e kulmit kah ana perëndimore e ndërtesës ,zëvendësimin e vitrinës dhe renovimin e brendshëm të ndërtesës egzistuese me etazhitet P+O në ngastrën kadastrale P-71813068-03175-0 në rrugën “Sheshi i Shadrvanit “- Prizren në etazhitet P+Nk. , e në bazë të nenit 3 paragrafit 1,pika 1.27,1.28 të Ligjit për Planifikimit Hapsinor me Nr.04/L-174 të Dt.31.07.2013 si dhe nenit 3.1.1,1.2,1.4,1.17,1.24, e në lidhje me nenin 4 pika 1.2 si dhe nenit 5 pika 1.2 si dhe nenin 14. Pika 1.2,të Ligjit për ndërtim nr. 04/L-110, dhe sipas nenit 3 pika 1.1,1.3,1.5,1.6,1.7 dhe 1.8 e lidhur me nenin 5,8 dhe 16 të Ligjit nr.04/L-066 për Qendrën Historike - Prizren dhe të nenit 85 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 27,44,46,47,48 të L,P.P.A nr.05/L-031 dt. 25.05.2016 dhe Vendimit për miratimin HZK për periudhën 2022-2030 Nr.001-011-48192 të dt 31.03.2022,merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. Aprovohet kërkesa e **Nikollë Kaçinarit** me nr. **04-353/01-26420** e datës **27.02.2025** për dhënjën e pëlqimit për ngritjen e kulmit kah ana perëndimore e ndërtesës ,zëvendësimin e vitrinës dhe renovimin e brendshëm të ndërtesës egzistuese me etazhitet P+O në ngastrën kadastrale P-71813068-03175-0 në rrugën “Sheshi i Shadrvanit “- Prizren në etazhitet P+Nk.
- II. Dokumentacioni teknik -Projekti Kryesor i punuar nga byroja projektuese “**DIARKO**”.
- III Datën e fillimit të punimeve investitori është i obliguar që të lajmërojë inspektionin komunal në afat prej 8 ditësh.

Investitori është i obliguar që punimet të kryhen në bazë të dokumentacionit teknik-projektit e në pajtim me normat ndërtimore dhe rregullat të përkohshme teknike për kësi llojë punime .

- IV. Investitori duhet të përmbahet pëlqimit
- Vendim I QRTK-së me nr.78-2 të dt.14.03.2025.
 - Rekomandimi i KTK i Qendrës Historike të Prizrenit të dt. 26.03.2025.
- V. Pas kryerjes së punimeve Investitori është i obliguar që vend punishten menjëherë të bjerë në gjendje të mëparshme.
- VI. Pas përfundimit të punimeve Investitori duhet të parashtrojë kërkesën për pranimin teknik dhe marrjen e lejes për shfrytëzim.
- P.S. Investitori gjatë implementimit të projektit merr përsipër për problemet eventuale që mund të dalin lidhur me infrastrukturë dhe çështje pronësore juridike duke bërë zgjidhje sa më të mire të mundshme.

A r s y e t i m


- Nikollë Kaçinari është drejtuar këtij organi me kërkesë për dhënjen e pëlqimit për ngritjen e kulmit kah ana perëndimore e ndërtesës ,zëvendësimin e vitrinës dhe renovimin e brendshëm të ndërtesës egzistuese me etazhitet P+O në ngastrën kadastrale P-71813068-03175-0 në rrugën “Sheshi i Shadrvanit “- Prizren në etazhitet P+Nk.

Pas shqyrtimit të kërkesës dhe dokumentacionit , si dhe bazuar në Ligjin për Ndërtim Nr. 04/L-110, Ligjin Nr. 02/L-28 të Procedurës Administrative dhe dispozitat tjera të ligjit në fuqi, u konstatua se janë plotësuar të gjitha kushtet e parapara ligjore për lëshimin e Lejes Ndërtimore, andaj u vendos si në dispozitiv

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 30 ditësh nga dita e marjes së të njëjtës MMPHI-së – Prishtinë.

Bashkëpunëtor profesional:


Afërdita Mormorina, inxh. dip. ark.



Drejtori:


Pranverim Berisha, jur